TARIK

TARIFA E INTEGRUAR E KOSOVËS

VERZIONI 01.01.2026

PARATHËNIE

Tarifa e Integruar e Kosovës (TARIK) përbëhet nga Nomenklatura e Mallërave (kodet dhe përshkrimet) e cila bazohet në Sistemin e Harmonizuar të Organizatës Doganore Botërore(WCO) dhe në Nomenklaturën e Kombinuar të Komunitetit Europian, që fillon të zbatohet me datën 1 Janar 2025.

Duke pasur parasysh se disa masa specifike të Kosovës nuk mund të trajtohen përbrenda kornizës së Nomenklaturës së Kombinuar, ka qenë e nevojshme që të krijohen nënkapituj shtesë në nivelin e TARIK-ut (shifra e 9 dhe 10).

Përshkrimet, në të cilat është inkorporuar Nomenklatura e Mallrave, formojnë Tarifën e Integruar të Kosovës.
(Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë (Ligji Nr. 08/L-247 të datës 10 Maj 2024) dhe Udhzimi Administrativ Nr. 2005/15 të 19 Gushtit 2005) Nomenklatura e Mallërave, shënimet e seksionit, shënimet e kapitullit, shënimet e nën kapitullit dhe shënimet shtesë janë detyrueshme me ligj.

Të gjithë artikujt e tjerë janë paraqitur për të lehtësuar referencën. Në rast të dyshimit apo kontestit, janë këto tekste ligjore të cilat janë të detyrueshme me ligj.

Tarifa e Integruar e Kosovës (TARIK) përbëhet prej 3 pjesëve:
- Pjesa e Parë: Dispozitat fillestare
- Pjesa e Dytë: Përshkrimet
- Pjesa e Tretë: Anekset

Dogana e Kosovës do të bëjë rregullisht ndryshimet e duhura në Tarifën e Integruar të Kosovës (TARIK) për të marrë për bazë legjislacionin e ri, sipas udhëzimit administrativ të lëshuar nga Drejtori Gjeneral,

Tarifa e Integruar e Kosovës është në dispozicion në Webfaqen e Doganës së Kosovës dhe në formë të CD-ROM-it.

PËRMBLEDHJE

PJESA E PARË—DISPOZITAT FILLESTARE

Seksioni I —Rregullat e përgjithshme

A. Rregullat e përgjithshme për interpretimin e Nomenklaturës së Mallrave
B. Direktivat për interpretim të Nomenklaturës së Mallrave
C. Rregullat e përgjithshme të zbatueshme si për Nomenklaturën e Mallrave ashtu edhe për detyrimet doganore
D. Mallrat me status preferencial
   Aplikimi i detyrimeve doganore preferenciale te Importi i mallrave me origjinë prej vendeve të cilat e kanë ratifikuar Marrëveshjen për amendimin dhe zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA-2006):

Seksioni II —Përshkrimi i TARIK-ut

A. Struktura e kodeve të mallrave
B. Njësitë plotësuese (Suplementare)
C. Masat e politikës tregtare
D. Normat preferenciale të detyrimit
E. T.V.SH.
F. Akciza

Seksioni III —Dispozitat e veçanta

A. Avionët civil dhe mallrat për përdorim në aviacionin civil
B. Produktet farmaceutike
C. Kontenierët dhe materialet paketues (ambalazhues)
D. Trajtime favorizuese tarifore për shkak të natyrës së mallit

Shenjat, shkurtesat dhe simbolet

PJESA E DYTË — PËRMBLEDHJE

Seksioni I

Kafshët e gjalla;produktet me origjin prej kafshëve

Kapitulli 01	Kafshët e gjalla.
Kapitulli 02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit
Kapitulli 03	Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme, molusqet dhe kafshët e tjera jovertebrore ujore
Kapitulli 04	Produktet bulmetore; vezët e zogjve;mjaltë natyral; produkte të ngrënshme me origjinë prej kafshëve,të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër
Kapitulli 05	Produktet me origjinë prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër

Seksioni II

Produktet Vegjetale

Kapitulli 06	Pemët dhe bimët e tjera, të gjalla; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashmet me to; lulet e prera dhe gjethnajat zbukuruese
Kapitulli 07	Zarzavatet(perimet) e ngrënëshme dhe rrënjët dhe tuberat përkatës
Kapitulli 08	Frutat dhe arrat e ngrënëshme; lëkurat e agrumeve apo të pjeprave
Kapitulli 09	Kafe, çaj, mate dhe erëza
Kapitulli 10	Drithërat
Kapitulli 11	Produktet e industrisë bluajtëse; malt; niseshtet; inulinë; gluteni i grurit
Kapitulli 12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia.
Kapitulli 13	Lac; gomat, rrëshirat, dhe ekstrakte të tjera vegjetale
Kapitulli 14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje, produktet vegjetate të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër

Seksioni III

Vajra dhe dhjamra prej kafshëve apo vegjetate dhe produktet e ndarjes së tyre, yndyrna të përgatitura të ngrënëshme, dyllet prej kafshëve apo vegjetate

Kapitulli 15	Vajra dhe dhjamra prej kafshëve apo vegjetate dhe produktet e ndarjes së tyre, yndyrna të përgatitura të ngrënëshme, dyllet prej kafshëve apo vegjetate

Seksioni IV

Ushqime të përgatitura;Pijet, alkoolet dhe Uthullat; duhanet dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit

Kapitulli 16 Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, prej molusqeve apo prej kafshëve të tjera jovertebrore ujore
Kapitulli 17 Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij
Kapitulli 18 Kakao dhe prëgatitjet prej kakaos
Kapitulli 19 Përgatitjet prej drithrave, të miellit, niseshtës apo qumështit; produktet e pasticerisë apo prej brumërave
Kapitulli 20 Përgatitje prej zarzavateve, frutave apo pjesëve të tjera të bimëve
Kapitulli 21 Përgatitje të ndryshme të ngrënëshme
Kapitulli 22 Pijet, alkoolet dhe uthullat
Kapitulli 23 Mbetjet dhe kthimet nga industritë ushqimore; tagjia e përgatitur për kafshët
Kapitulli 24 Duhani dhe zevendesuesit e duhanit të prodhuar; produktet që përmbajnë apo jo nikotinë, të destinuar për inhalim pa djegie; produkte tjera që përmbajnë nikotinë të destinuara për konsum të nikotinës në trupin e njeriut

Seksioni V

Produktet Minerale

Kapitulli 25 Kripërat; sulfuret; oksidet dhe gurët; materialet suvatuese, gëlqere dhe çimento
Kapitulli 26 Xeheroret, zgjyrat dhe hiri
Kapitulli 27 Lendët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre; substancat bituminoze; dyllet minerale

Seksioni VI

Produktet e Industris kimike apo të industrive të lidhjeve

Kapitulli 28 Kimikatet inorganike;përbërjet organike dhe inorganike të metaleve të çmuar, të metaleve të rrallë, të elementeve radioaktive apo të izotopeve.
Kapitulli 29 Kimikatet organike
Kapitulli 30 Produktet farmaceutike
Kapitulli 31 Plehëruesit
Kapitulli 32 Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike; taninet dhe derivatet e tyre; ngjyrosësit, pigmentet dhe lëndë të tjera ngjyrosëse, bojrat dhe llustrosesit; stuko dhe masticet e tjera, bojrat e shkrimit

Kapitulli 33 Vajrat thelbësore dhe rrëshirat; preparatet e parfumerisë, kozmetikës, apo të tualetit
Kapitulli 34 Sapuni, agjentet organike me veprim të sipërfaqshëm, preparatet larëse, preparatet lubrifikuese, dyllet artificiale, dyllet e pregatitura, preparatet llustrosëse apo pastrues, qirinjtë dhe artikuj të ngjashëm, pastat modeluese, "dyllet dentare" dhe preparatet dentare me bazë allçie.
Kapitulli 35 Substanca albuminoidale; niseshtetë e modifikuara;ngjitësat; enzimat
Kapitulli 36 Eksplozivët; produktet piroteknike; shkrepset; lidhjet piroforike; preparatet e caktuara të djegshme
Kapitulli 37 Mallrat fotografike apo kinematografike
Kapitulli 38 Produkte të ndryshme kimike

Seksioni VII

Plastikat dhe artikujt prej tyre;goma dhe artikujt prej saj

Kapitulli 39 Plastikat dhe artikujt prej tyre
Kapitulli 40 Goma dhe artikujt prej saj

Seksioni VIII

Lëkurat e papërpunuara, lëkurët e përpunuara, gëzofet dhe artikujt prej tyre;takëmet e kalit, samarët, mallrat e udhëtimit, çanta dore dhe kontenierë të ngjashëm;artikujt prej të brendshmëve të kafshëve(përveç zorrëve të krimbit të mëndafshit)

Kapitulli 41 Lëkurët e papërpunuara (përveçse gëzofeve) dhe lëkurët e përpunuara
Kapitulli 42 Artikujt prej lëkure; samarët dhe takëmet e kalit; mallrat e udhetimit, çantat e dorës dhe kontenierë të ngjashëm; artikuj prej të brendshmeve të kafshëve(përveç të zorrëve të krimbit të mëndafshit)
Kapitulli 43 Gëzofet dhe qimet artificiale; prodhimet prej tyre

Seksioni IX

Druri dhe artikujt prej druri; qymyri i drurit; tapa dhe artikujt prej tape; prodhimet prej kashte prej esparto apo prej materialeve të tjera gërshetuese;punët në xunkth apo kallama

Kapitulli 44 Druri dhe artikujt prej druri, qymyri i drurit
Kapitulli 45 Tapa dhe artikujt prej tape

Kapitulli 46 Prodhimet e kashtës, të espartos apo të materialeve të tjera thurëse; punimet në xunkth dhe kallama

Seksioni X

Brumi i drurit apo materialeve të tjera fibroze celulozike;letër dhe karton i rikuperueshëm (mbetje dhe kthime); letër dhe karton dhe artikujt prej tyre

Kapitulli 47 Brumi i drurit apo i materialeve të tjera flbroze celulozike; letër dhe karton i rikuperueshëm (mbetje dhe kthime)
Kapitulli 48 Letra dhe kartoni., artikuj prej brumit të letrës,perj letre apo kartoni
Kapitulli 49 Librat, revistat, pikturat dhe produkte të tjera të industrisë së shtypit, dorëshkrimet; shtypshkrimet dhe projektet

Seksioni XI

Tekstilet dhe artikujt tekstile

Kapitulli 50 Mëndafshi
Kapitulli 51 Leshi, qime të holla apo të ashpra kafshësh; fije prej flokëve të kalit dhe pëlhura të endura prej tyre
Kapitulli 52 Pambuku
Kapitulli 53 Fibra të tjera tekstile vegjetale; fill letre dhe pëlhura të endura prej fijeve prej letre
Kapitulli 54 Filamentet e bëra nga njerëzit; shirita dhe të ngjashme nga materialet e tekstilit të bëra nga njerëzit
Kapitulli 55 Fibrat kryesore të bëra nga njerëzit
Kapitulli 56 Mbushje, shajak dhe pëlhura të paendura; fijet speciale; spango, kordone, litar dhe kabllo dhe artikujt prej tyre
Kapitulli 57 Qilimat dhe veshje të tjera të dyshemesë prej tekstili
Kapitulli 58 Pëlhura speciale të endura; pëlhura tekstile me xhufka; tantellat; tapicerite; zbukurimet, qëndismat
Kapitulli 59 Pëlhurat tekstile të ngopura, të veshura, të mbuluara apo të laminuara, artikujt tekstile të një lloji të përshtatshëm për përdorim industrial
Kapitulli 60 Pëlhurat e thurura me shtiza apo të punuara më grep
Kapitulli 61 Artikuj të veshjes dhe plotësues të veshjeve, të thurura me shtiza apo të punuara me grep
Kapitulli 62 Artikuj të veshjes dhe plotësues të veshjeve, jo të thurura me një apo me shumë file
Kapitulli 63 Artikuj të tjerë të bërë me tekstile;kompletet; veshjet e përdorura dhe artikuj tekstile të përdorur; lecka mbeturine.

Seksioni XII

Veshjet e këmbëve, veshjet e kokës,çadrat, çadrat e diellit, bastunet,bastunet mbështetës, kamzhiqet,artikujt për gjueti dhe pjesët prej tyre; puplat e përgatitura dhe artikujt e bërë me to;Lulet artificiale; artikuj të flokëve të njerëzve.

Kapitulli 64 Veshjet e këmbëve, galloshet dhe të ngjashmet e tyre. pjesët e artikujve të tillë
Kapitulli 65 Veshjet e kokës dhe pjesët prej tyre
Kapitulli 66 Çadrat, çadrat e diellit, bastunet, bastunet mbështetës, kamzhiqet, artikujt për gjueti dhe pjesët e tyre
Kapitulli 67 Puplat dhe pushi i përgatitur dhe artikujt e bërë nga puplat dhe pushi; lulet artificiale, artikujt prej flokëve të njerëzve

Seksioni XIII

Artikujt prej guri, allçie, çimentoje, asbesti, mike apo materiale të ngjashme,produktet qeramike;qelqi dhe prodhimet prej qelqi

Kapitulli 68 Artikujt prej guri, allçie, çimentoje, asbesti, mike apo materiale të ngjashme
Kapitulli 69 Produkte qeramike
Kapitulli 70 Qelqi dhe prodhimet prej qelqi

Seksioni XIV

Perlat natyrale apo të kultivuara, gurët e çmuar apo gjysëm të çmuara, metalet e çmuar, metale të veshur me metale të çmuar dhe artikujt prej tyre; imitacionet e bizhuterive;monedha

Kapitulli 71 Perlat natyrale apo të kultivuara, gurët e çmuar apo gjysëm të çmuara, metalet e çmuar, metale të veshur me metale të çmuar dhe artikujt prej tyre; imitacionet e bizhuterive;monedha

Seksioni XV

Metalet bazë dhe artikujt prej metaleve bazë

Kapitulli 72 Giza dhe çeliku
Kapitulli 73 Artikujt prej gize dhe çelikut
Kapitulli 74 Bakri dhe artikujt prej bakri
Kapitulli 75 Nikeli dhe artikujt prej tij
Kapitulli 76 Alumini dhe artikujt prej tij
Kapitulli 77 (E rezervuar për shfrytzim të mundshëm në të ardhmën në sistemin e harmonizuar))
Kapitulli 78 Plumbi dhe artikujt prej tij
Kapitulli 79 Zinku dhe artikujt prej tij
Kapitulli 80 Kallaji dhe artikujt prej tij
Kapitulli 81 Metale të tjerë bazë, metaloqeramikat, produktet prej tyre
Kapitulli 82 Veglat e punës. pajisjet e punës, takëmet e ngrënies,lugët dhe pirunët, prej metali bazë; pjesë e tyre prej metali bazë

Kapitulli 83 Artikuj te ndryshëm prej metali baze

Seksioni XVI

**Makineritë dhe pajisjet mekanike; pajisje elektrike; pjesët e tyre;
rregjistruesit dhe riprodhuesit e tingullit, rregjistruesit dhe riprodhuesit e imazhit televiziv dhe të zërit,
pjesët dhe plotësuesit e këtyre artikujve**

Kapitulli 84 Reaktorët nuklearë.kaldajat(boilerët), makineritet dhe pajisjet mekanike, pjesët e tyre
Kapitulli 85 Makineri dhe paisje elektrike dhe pjesët e tyre; regjistruesit dhe riprodhuesit e tingullit; regjistruesit dhe riprodhuesit e imazhit televiziv dhe zërit. pjesët dhe plotësuesit këtyre artikujve

Seksioni XVII

Mjetet e transportit rrugor,ajror dhe detar dhe pajisjet shoqëruese të transportit

Kapitulli 86 Lokomotivat e hekurudhave apo tramvajeve, vagonët dhe pjesët e tyre; fiksuesit dhe përshtatjet e shinave të hekurudhave apo tramvajeve dhe pjesët e tyre; pajisjet mekanike të sinjalizimit (përfshirë ato elektro-mekanike) të të gjitha llojeve
Kapitulli 87 Mjetet e transportit të ndryshëm nga vagonët e hekurudhës ose tramvajit, pjesët dhe plotësuesit e tyre
Kapitulli 88 Avionët, anijet e hapësirës, dhe pjesët e tyre
Kapitulli 89 Anijet, varkat dhe strukturat lundruese

Seksioni XVIII

**Istrumentet dhe aparatet optike,fotografike,kinematografike,matëse,kontrolli,saktësie,
mjeksore ose kirurgjikale;orët e të gjitha llojeve;instrumentet muzikore;pjesët dhe plotësuesit e tyre**

Kapitulli 90 Instrumentet dhe aparatet optike, fotografike, kinematografike, matës, kontrolli, saktësie, mjeksore ose kirurgjikale; pjesët dhe plotësuesit e tyre
Kapitulli 91 Orët e të gjitha llojeve dhe pjesët e tyre
Kapitulli 92 Instrumentet muzikore; pjesët dhe plotësuesit e artikujve të tille

Seksioni XIX

Armët dhe municionet; pjesët dhe plotësuesit e tyre

Kapitulli 93 Armë dhe municionet; pjesët dhe plotësuesit e tyre

Seksioni XX

Artikuj të ndryshëm të prodhuar

Kapitulli 94 Mobilerite; Krevatet, dyshekët, mbajtëset e dyshekëve, jastëqet dhe shtresa të ngjashme të mbushura; llampat dhe pajime ndriçimi, jo të përfshira apo të specifikuara diku tjetër; shenjat ndriçuese, pllakat e emrit ndriçuese dhe të ngjashmet e tyre; ndërtesat e parafabrikuara
Kapitulli 95 Lodrat, pajisjet e lojrave dhe ato sportive; pjesët dhe pajisjet shtesë të tyre
Kapitulli 96 Artikuj të ndryshëm të prodhuar

Seksioni XXI

Veprat e artit,copat e mbledhura nga koleksionistët dihe antikat

Kapitulli 97 Veprat e artit,copat e mbledhura nga koleksionistët dihe antikat

PJESA E TRETË — ANEKSET

Aneksi 01 LISTA E EMRAVE NDERKOMBËTARE JO-PRONONSORE (INNS), QË PËRMBAJNË SUBSTANCA FARMACEUTIKE NGA ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETËSISË, TË CILAT JANË TË LIRUARA NGA DETYRIMET

Aneksi 02 LISTA E PREFIKSËVE DHE SUFIKSEVE TË CILËT ,NË KOMBINIM ME INNS TË ANEKSI 01, PËRSHKRUAJNË KRIPËRAT, ESTERET APO HIDRATET E INNS;KËTO KRIPËRA, ESTERE, APO HIDRATE JANË TË LIRUARA NGA DETYRIMET ME KUSHT QË JANË TË KUALIFIKUESHME NË SH-NËNKAPITULLIN E NJEJTË 6-SHIFROR SIKURSE INN-i PËRKATËS

Aneksi 03 KRIPËRAT, ESTERET DHE HIDRATET E INNS,TË CILAT NUK JANË TË KUALIFIKUARA NË SH-KAPITULLIN E NJEJTË SIKURSE EDHE INNS-at PËRKATËS DHE TË CILËT JANË TË LIRUAR NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TVSH

Aneksi 04 LISTA E INTERMEDIARVE FARMACEUTIKE DMTH TË KOMPONENTEVE QË PËRDOREN PËRPRODHIMIN E PRODUKTEVE FINALE FARMACEUTIKE TË PËRFUNDUARA TË CILAT JANË TË LIRUARA NGA DETYRIMET

Aneksi 05 CERTIFIKATA VETERINARE

Aneksi 06 CERTIFIKATA FITOSANITARE

Aneksi 08 LICENCA DHE CERTIFIKATA NGA AGJENCIONI I KOSOVËS PËR PRODUKTE MEDICIONALE

Aneksi 09 LICENCA PËR NAFTËN DHE PRODUKTET NGA NAFTA

Aneksi 10 AUTORIZIM IMPORTI PËR PERKURSOR (AKPM)

Aneksi 11 LICENCA PËR IMPORT TË NARKOTIKËVE-L3p (AKPM)

Aneksi 12 LICENCA PËR IMPORT TË NARKOTIKËVE-L3n (AKPM)

PJESA E PARË

DISPOZITAT FILLESTARE

SEKSIONI I

RREGULLAT E PËRGJITHSHME

A. Rregullat e përgjithshme për interpretimin e Nomenklaturës së mallrave

Klasifikimi i mallit në Nomenklaturën e mallrave të Tarifës së Integruar të Kosovës (TARIK) do të rregullohet përmes parimeve që pasojnë:

1. Titujt e Seksioneve, Kapitujve dhe nënkapitujve janë dhënë vetëm për lehtësi referimi; për qëllime ligjore, klasifikimi do të përcaktohet në përputhje me kushtet e krerëve dhe shënimeve të ndonjë seksioni apo kapitulli përkatës dhe, me kusht që të tilla krerë ose shënime nuk e kërkojnë ndryshe, klasifikimi përcaktohet sipas dispozitave në vijim.

2. (a) Çdo referim për një artikull në një kre do të merret sikur përfshin edhe një referim për atë artikull të paplotësuar apo të pambaruar, me kusht që, ashtu siç është paraqitur, artikulli i pambaruar apo i paplotësuar ka karakterin thelbësor të artikullit të plotësuar apo të mbaruar.
   Poashtu do të merret sikur përfshin një referencë për atë artikull të plotësuar apo të mbaruar, (ose që mund të klasifikohet si i mbaruar apo i plotësuar sipas këtij rregulli), por të paraqitur në formë të pambledhur apo të shpërndarë.

   (b) Çdo referencë në një kre për një material apo substancë do të merret sikur përfshin një referencë për përzierjet apo kombinimet e atij materiali apo substance me materiale apo substanca të tjera. Çdo referencë për mallërat e atij materiali apo substance të dhënë, do të merret sikur përfshin një referencë për mallërat e përbëra tërësisht apo pjesërisht prej materialeve apo substancave të tilla.
   Klasifikimi i mallrave të përbëra nga më shumë se një material apo substancë do të bëhet në përputhje me parimet e Rregullit (3).

3. Nëse, me zbatimin e rregullit 2 (b) ose për ndonjë arsye tjetër, mallrat në pamje të parë, janë të klasifikueshme në dy apo më shumë krerë, klasifikimi do të kryhet si më poshtë:

(a) Kreu i cili jep përshkrimin më specifik do të preferohet nga krerët që japin një përshkrim më të përgjithshëm. Megjithatë, kur dy apo më shumë krerë secila i referohet vetëm pjesës së materialeve apo substancave që bejnë pjesë në mallrat e përbëra apo të përziera, apo vetëm pjesës së artikujve në një grup të përgatitur për shitjen me pakicë, këta krerë do të vleresohen njëlloj të specifikuar në lidhje me këto mallra, edhe nëse njëri prej tyre jep një përshkrim më të saktë apo më të plotë të mallrave;

(b) Mallrat e përbëra dhe përzierjet që përbëhen nga materiale apo komponente të ndryshëm dhe mallrat e vendosura në një grup për shitjen me pakicë, të cilat nuk mund të klasifikohen sipas rregullit 3 (a), do të klasifikohen njejtë sikur ato të përbëhen nga materialet apo komponenti që i jep atyre karakterin thelbësor, aq sa është e mundur të zbatohet ky kriter;

(c) Kur mallrat nuk mund të klasifikohen sipas rregullave 3(a) apo 3(b), ato do të klasifikohen në kreun i cili ndodhet i fundit në rendin numerik, midis atyre mallrave që meritojnë të njejtin vlerësim.

4. Mallrat që nuk mund të klasifikohen sipas rregullave të mësipërme do të klasifikohen në kreun që i përgjigjet mallrave me të cilat ato janë më së shumti të ngjashme.

5. Në shtesë të rregullave të mësipërme, rregullat e mëposhtme do të zbatohen përsa i përket mallrave të referuara këtu:

(a) Kutite e kamerave, kutite e instrumentave muzikore, kutite e armëve, kutitë e veglave të pikturës, kutitë e bizhuterive dhe kontejnerët e ngjashëm të përshtatur veçanerisht për të futur një artikull apo grup artikujsh të veçantë, të përshtatshëm për përdorim afatgjatë dhe të paraqitur së bashku me artikujt për të cilët ato janë bërë, do të klasifikohen me artikuj të tillë, kur ata janë të një lloji, që shiten normalisht menjëherë bashkë me të. Por, ky rregull nuk zbatohet për kontenierët që i japin tërësisë karakterin e tij thelbësor;

(b) në varësi nga dispozitat e rregullit 5 (a) më lart, materialet paketuese dhe kontenierët paketues[(1)] të paraqitur bashkë me mallrat brenda do të klasifikohen me këto mallra, nëse ato janë të një lloji normalisht të përdorur për paketimin e mallrave të tillë. Por kjo dispozitë nuk është e detyrueshme kur të tilla materiale paketuese apo kontenierë shihet qartë se janë të përshtatshme për ripërdorim.

6. Për qëllime ligjore, klasifikimi i mallrave në nënkrerët e një kreu, do të përcaktohet në përputhje me kushtet e këtyre nënkrerëve dhe të ndonjë Shënimi të nënkrerëve përkatës dhe, mutatis mutandis, sipas rregullave të mësipërme, duke qenë e kuptueshme se vetëm nënkrerët e të njejtit nivel janë të krahasueshëm. Për qëllime të këtij rregulli, Shënimet përkatëse të Seksioneve dhe Kapitujve zbatohen gjithashtu, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe.

---

(1) Termi ‘materialet paketuese’ dhe ‘kontenierë paketues ’dmth kontenierë të jashtëm apo të mbrenshëm,mbajtës, mbështjellës apo ndihmës ndryshe nga pajisjet e transportit (psh kontenierë për transport), pëlhurë e gomuar, pajisje apo pajisjet të tjera ndihmëse.Termi ‘kontenierë paketues’ nuk i përfshin kontenierët e referuar në rregullën e përgjithshme 5(a).

B. Direktivat për interpretim të Nomenklaturës së Mallrave

Për klasifikimin e mallrave në kapituj dhe nënkapituj që përfshijnë gjashtë shifrat e para të kodit të mallrave, ne i referohemi Shënimeve Shpjeguese aktuale të Sistemit të Harmonizuar të Organizatës Botërore Doganore.

Për klasifikimin e mallrave në nënkapitujt nga shtatë apo tetë shifrat e kodit të mallrave ne i referohemi Shënimeve Shpjeguese aktuale të Nomenklaturës së Kombinuar të Komunitetit Europian.

Për klasifikimin e mallërave në nënkapitujt në të cilat janë të përfshirë edhe shifra e nëntë dhe e dhjetë e kodit të mallrave, ne i referohemi këtij Prezentimi, shënimeve shtesë të (TARIK-ut) dhe Ligjit të tanishëm të Kosovës.

C. Rregullat e përgjithshme të zbatueshme si për Nomenklaturen e Mallrave ashtu edhe për detyrimet doganore

1. Detyrimet doganore të shprehura në formë të përqindjes janë detyrime ad valorem.
   Detyrimet e tilla doganore duhet të llogariten mbi vlerën doganore të mallrave të importuara.
   Vlera doganore e mallrave të importuara duhet të caktohet sipas metodave të përshkruara në librin e parë, Kapitullin III të Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë (Ligji Nr.08/L-247 të datës 10 Maj 2024).

2. Përveç rasteve kur parashihet ndryshe, dispozitat në lidhje me vlerën doganore duhet aplikuar në mënyrë që përveç vlerës për llogaritjen e detyrimeve ad valorem, të përcaktohen edhe vlerat duke iu referuar të cilave përkufizohet edhe fusha e kapitullit apo nënkapitullit të caktuar.

3. Mallrat që kualifikohen për trajtim të favorshëm tarifor për arsye të përdorimit final të tyre:
   Në rastet kur detyrimi i importit që zbatohet për mallra të cilat do të përdoren për një qëllim specifik final sipas një marrëveshjeje për përdorim final nuk është më ulët sesa detyrimi i importit që përndryshe do të zbatohej për ato mallra, atëherë mallrat në fjalë duhet të klasifikohen në kodin e TARIK-ut që ka të bëjë me përdorimin final.

D. Mallrat me status preferencial

❖ Aplikimi i detyrimeve doganore preferenciale te Importi i mallrave me origjinë prej vendeve të cilat e kanë ratifikuar Marrëveshjen për amendimin dhe zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA-2006):

- Prej datës 26 Korrik 2007 aplikohet për mallrat me origjinë prej: Republikës së Shqipërisë (AL), Republikës së Maqedonisë (MK), Republikës së Malit të Zi (ME), Republikës së Moldavisë (MD).

- Prej datës 24 Tetor 2007 aplikohet për mallrat me origjinë prej Republikës së Serbisë (XS);

- Prej datës 22 Nëntor 2007 aplikohet për mallrat me origjinë prej Bosnjes dhe Hercegovinës (BA).

1. Për të fituar statusin preferencial në kontekst të kësaj Marrëveshjeje, origjina e produkteve dëshmohet me një certifikatë qarkullimi EUR 1 ose "deklaratë e origjinës" e dhënë nga Exportuesi ne harmoni me nenin 21 (1) Titulli V , ashtu siç është përshkruar në Marrëveshjen CEFTA-2006

- Aplikimi i detyrimeve doganore preferenciale te Importit të mallrave me origjinë prej vendeve të cilat e kanë ratifikuar marrëveshjen e Stabilizim asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe komunitetit Evropian të energjisë atomike (MSA 2016), në anën tjetër sipas Ligjit Nr. 05/L -069 sipas shtojcave përkatëse;
- Prej datë 01 Prill 2016 aplikohet për mallrat me origjin prej: Austria(AT), Belgjika(BE), Bullgaria(BG), Kroacia (HR), Republika e Qipros(CY), Republika Çeke(CZ), Danimarka(DK), Estonia (EE), Finlanda (FI), Franca (FR), Gjermania (DE), Greqia(GR), Hungaria(HU), Irlanda (IE), Italia (IT), Letonia (LV), Lituania (LT), Luksemburgu (LU), Malta (MT), Holanda (NL), Polonia (PL), Portugalia (PT), Rumania (RO), Sllovakia (SK), Sllovenia (SL), Spanja (ES), Suedia)SE) .
- Mbretëria e Bashkuar (GB).
- Prej datës 01.09.2019 ka hyr në fuqi marveshja e tregëtis së lir në mes të Republikes të Kosoves dhe Republikes të Turqisë nr. Dekreti 122/2019.

2. Për të fituar statusin preferencial në kontekst të kësaj Marrëveshjeje, origjina e produkteve dëshmohet me një certifikatë qarkullimi EUR 1 ose "deklaratë e origjinës" e dhënë nga Exportuesi ne harmoni me nenin 21 (1) Titulli V, ashtu siç është përshkruar në Marrëveshjen e stabilizim asocimit (MSA 2016).
   ❖ Për të fituar statusin preferencial në kontekst të kësaj Marrëveshjeje, origjina e produkteve dëshmohet me një certifikatë qarkullimi EUR 1 ose "deklaratë e origjinës" e dhënë nga Exportuesi.

SEKSIONI II

PËRSHKRIMI I TARIK

Tarifa e Integruar e Kosovës, e quajtur si TARIK, është bazuar në Sistemin e Harmonizuar (S.H) të Organizatës Boterore Doganore (WCO) dhe në Nomenklaturën e Kombinuar të Unionit Europian dhe përmban:

- kodin e mallrave
- përshkrimin e mallërave
- njësitë shtesë të obligueshme (ZYRËS STATISTIKORE TË KOSOVËS dhe EUROSTAT)
- nje referencë për legjislacionin e Kosovës që ka të bëjë me masat e ndryshme të politikës tregtare që zbatohen për import dhe/ose eksport
- normat e aplikueshme të detyrimeve doganore
- normat preferenciale të detyrimeve për vendet të cilat e kanë ratifikuar Marrëveshjen për amendimin dhe zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA-2006) dhe (MSA) (GB) dhe MTLTR.(të cekura më lart):

  - - Republikën e Shqipërisë (AL);
  - - Bosnjën e Hercegovinën (BA).

- - Republikën e Moldavisë (MD);
- - Republikën e Malit të Zi (ME);
- - Republikën e Maqedonisë (MK);
- - Republikën e Serbisë (XS);

- normat e TVSH-së

- normat e Akcizës

A. Struktura e kodit të Mallrave


Kodi i mallrave (Tarik kodi) është përmendur në shtyllën e parë dhe është strukturuar si vijon:

Gjashtë shifrat e para paraqesin numrat e kodit që i përkasin kapitujve dhe nënkapitujve të Nomenklaturës së Sistemit të harmonizuar (WCO).

Shifra e shtatë dhe e tetë identifikon nënkapitujt e Nomenklaturës së Kombinuar të Komunitetit Evropian.

Shifra e nëntë dhe e dhjetë rezervohet për përdorimin e nënkapitujve që dalin nga legjislacioni i Kosovës.
Në mungesë të nënndarjes për TARIK të Kosovës, shifrat nëntë dhe dhjetë do të jenë me “00”.

Në raste të veçanta, edhe një kod katërshifror i TARIK-ut mund të përdoret për zbatimin e masave specifike të Kosovës të cilat nuk janë të koduara, apo të cilat nuk janë në tërësi të koduara (siç janë “produktet farmaceutike”).


1 2 3 4 5 6 7 8
9 10
1 2 3 4
1 2 3 4 5 6
Sistemi i Harmonizuar (S.H) (WCO)
7 8
Nomenklatura e Kombinuar (komuniteti Evropian)
9 10
TARIK (Kosovë)
1 2 3 4
Kodi i parë shtesë i TARIK-ut

B. Njësitë plotësuese (shtesë)

Njësitë plotësuese (shtesë) të cilët janë të detyrueshme për qëllime statistikore (ZYRA STATISTIKORE E KOSOVËS dhe EUROSTAT) janë të shënuara në shtyllën e tretë.

Shkurtesat në vijim janë përdorur:

CCT	ct/l	Kapaciteti mbajtës në tonë ([1])
CEN	100 p/st	Njëqind artikuj
CTM	c/k	Karat (1 Karat metric =$2x10^{-4}$ kg)
GFJ	gi F/S	Grami i izotopeve të zbërthyeshme
GRM	g	Gram
KHO	Kg H_2O_2	Kilogram i peroksidit të hidrogjenit(KG H_2 O_2)
KLT	1000 l	Njëmij litra(1000 Litra)
KMA	kg met.am.	Kilogram të metilamines
KNE	kg/net eda	Kilogram të peshës neto të thatë
KNI	kg N	Kilogram të azotit
KPH	kg KOH	Kilogram i hidroksidit te kaliumit (potase kaustike) (KG KOH)
KPO	kg K_2O	Kilogram i oksidit të kaliumit (KG K_2O)
KPP	kg P_2 O_5	Kilogram të pentaoksidit të difosforit(KG P_2 O_5)
KSD	kg 90% sdt	Kilogram të substancës 90 % të thatë
KSH	kg NaOH	Kilogram të hidroksidit të natriumit (soda kaustike) (KG NaOH)
KUR	kg U	Kilogram të uraniumit
LPA	l alc. 100%	Litër në alkool të pastër (100%)
LTR	l	Litra
MIL	1000 p/st	Një mijë artikuj
MQM	1000 m^3	Një mijë Metër kub
MTK	m^2	Metër katrorë

([1]) Kapaciteti mbajtës i dobishëm në tonë' (CCT) nënkupton kapacitetin mbajtës të një ene të shprehur në ton, pa përfshirë depot e anijeve (lëndë djegëse, pajisjet, furnizimet ushqimore, etj). Personat që mbahen në bord (ekuipazhi dhe pasagjerët) dhe bagazhet e tyre janë gjithashtu të përjashtuara.

MTQ	m^3	Metër kubik
MTR	m	Metër
MWH	1000 kwh	Një mijë kilovatë orë
NEL	ce/el	Numri i elementeve
NPR	pa	Numri i çifteve
PCE	p/st	Numër artikujsh
TJO	TJ	Tera-xhaul (vlera kalorike bruto)
-		Nuk kan njësi shtesë

C. Masat e politikës tregtare

Një referencë e shkurtër për legjislacionin e Kosovës në lidhje me masat e politikës tregtare që zbatohen për import dhe/ose eksport janë bërë në shtyllën e katërt dhe të pestë.

- **"VET"** dmth Cerifikata Veterinare, e cila duhet të lëshohet nga autoritetet kompetente,është e nevojshme bazuar në vendimin 5079/10.12.2012 të vendosur nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV).
- **"FIT"** dmth Cerifikata Fitosanitare, e cila duhet të lëshohet nga autoritetet kompetente, është e nevojshme bazuar në vendimin 5079/10.12.2012 të vendosur nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV.
- "**L04"** dmth licenca e lëshuar nga Agjencioni i Kosovës për Produktet Medicionale,është e nevojshme
- **"L05"** dmth Importimi i prodhimeve të duhanit , duhanit të pa përpunuar, letres për cigare dhe letres në form tubi (UA MTI Nr. 11/2020) mundë të bëhet vetëm nga Importuesit e autorizuar nga Ministria e tregtisë gjegjsisht Departamentin e tregetisë për tregtimin e duhanit, Eksport të produkteve të duhanit përveq duhanit të pa fermentuar dhe të pa përpunuar
- **"L06"** dmth këkohet licenca për Importin e naftës dhe derivateve të naftës në Kosovë dhe për transportin e mëtutjeshëm të naftës dhe derivateve të naftës në Kosovë në kalimin kufitar.
- **"L07"** dmth Licenca e importit dhe eksportit të narkotikëve dhe licenca e importit dhe eksportit të prekursorëve e lëshuar nga Agjencioni i Kosovës për Produktet Medicionale, është e nevojshme për përshkrimet dhe synonimet e përshkrimeve nga tabelat II, III, IV të ligjit Nr. 02/L-128
- **"L08"** Çertifikatën për përshtatshmërinë e tipit të mjetit, udhëzim administrativ nr.2008/08 për homoligimin e automjeteve
- "**PRO"**dmth Ndalim

Shënimet në fund të faqes kanë të bëjnë me Ligjin e aplikueshëm dhe Licencat/Certifikatat e duhura, për të cilat mund të njoftoheni në Anekset 05 deri 12.

D. Normat preferenciale të detyrimit

Aplikohen sipas Marrëveshjes për amendimin dhe zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA-2006): Republikën e Shqipërisë (AL); Bosnjën e Hercegovinën (BA); Republikën e Moldavisë (MD); Republikën e Malit të Zi (ME); Republikën e Maqedonisë (MK); dhe Republikën e Serbisë (XS), si dhe sipas marrëveshjes së Stabilizim asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe komunitetit Evropian të energjisë atomike (MSA 2016), në anën tjetër sipas Ligjit Nr. 05/L -069 sipas shtojcave përkatëse

Ndikimi i këtyre Marrëveshjeve për Tregti preferenciale është përmendur në shtyllën e shtatë.

Shembull:

Norma preferenciale e detyrimit	**Interpretimi**
CEFTA (AL, BA,MD, ME, MK, XS)	
CEFTA : 0	Statusi preferencial (me EUR.1 ose "deklaratë e origjinës" e dhënë nga Exportuesi ne harmoni me nenin 21 (1) Titulli V): Norma zero për **CEFTA (AL, BA, MD, ME, MK, XS)**
AL, BA, MD, ME, MK, XS : 0	Statusi preferencial (me EUR. ose "deklaratë e origjinës" e dhënë nga Exportuesi ne harmoni me nenin 21 (1) Titulli V1): Norma zero për **AL, BA, MD, ME, MK, XS**
MSA:0 dhe shtojcave përkatëse të ligjit Nr. 05/L -069	Statusi preferencial (me EUR.1 ose "deklaratë e origjinës" e dhënë nga Exportuesi ne harmoni me nenin 21 (1) Titulli V): Norma zero për **AT, BE, BG, HR, CY, CZ, DK, EE, FI, FR, DE, GR, HU, IE, IT, LV, LT, LU, MT, NL, PL, PT, RO, SK, SL, ES, SE, GB**
Marveshja e tregtisë së lir në mes Republikes së Kosoves dhe Republikes të Turqisë	Statusi preferencial (me EUR. ose "deklaratë e origjinës" e dhënë nga Exportuesi për TR

E. TVSH

Normat e TVSH të aplikueshme për import/hyrje të produkteve janë përmendur në shtyllën e tetë.

F. Akciza

Normat e Akcizës të aplikueshme për import/hyrje të produkteve janë përmendur në shtyllën e nëntë.

Sasitë dhe përqindja e produkteve alkoolike

Ligjit Nr. 03/L-220

Përveç nëse ndryshe vërtetohet:

(a) sasia dhe përqindja e alkoolit në një produkt të alkoolit do të meret ajo sasi apo perqindje qe është paraqitur në etiketën e bashkangjitur apo shtypur në kontenierët që përmbajn produkte alkoolike; dhe
b) nëse sasia dhe përqindja e alkoolit nuk është e paraqitur në etiketën e shtypur apo bashkangjitur në kontenierët që përmbajn produkte alkoolike atëherë sasia dhe përqindja e alkoolit 100% në 20°C do të vlerësohet siç është parapare në tabelën pasuse:

SASITË DHE PËRQINDJET E ALKOOLIT

Përshkrimi	kodi	Sasia e Llogaritur	Llogaritja e përqindjes së Alkoolit
Birrë e bërë nga maltit	*2203*	*33.3 cl*	*5 % ndaj volumit të alkoholit absolut në temperaturë pre j 20°C*
Verë prej rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool; musht rrushi përveç atij të kreut Nr. 2009	*2204*	*75 cl*	*12.5 % ndaj volumit të alkoholit absolut në temperaturë pre j 20°C*
Vermuth dhe verëra të tjera prej rrushit të freskët aromatizuar me bimë apo me substanca aromatizuese	*2205*	*70 cl*	*20 % ndaj volumit të alkoholit absolut në temperaturë pre j 20°C*
Pije të tjera të fermentuara (psh, musht molle, musht dardhe, hidromel); përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve jo-alkoolike, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	*2206*	*75 cl*	*5 % ndaj volumi të alkoholit absolut në temperaturë pre j 20°C*
Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej më pak se 80 % vol; pije alkoolike, likere dhe alkoole të tjera	*2208*	*1 litër*	*40 % ndaj volumit të alkoholit absolut në temperaturë pre j 20°C*

SEKSIONI III

DISPOZITAT E VEÇANTA

A. **Avionët civil dhe mallrat për përdorim në aviacionin civil**

1. Lirimi nga taksat doganore jepet për:

   — avionët civil,

   — mallra të caktuara për përdorim në avionët civil dhe për tu trupëzuar në to gjatë procesit të prodhimit, riparimit, mirëmbajtjes, rindërtimit, modifikimit apo konvertimit,

   — trajnerët fluturues të tokës dhe pjesët prej tyre, për përdorim në avionët civil

   Këto mallra përfshihen nga krerët dhe nënkrerët të përshkruara në tabel sipas paragrafit 5.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, renditjen e pare dhe të dytë, “avionët civil” ka kuptimin e avioneve ndryshe nga avionët e përdorur në shërbimin ushtarak apo shërbime të ngjashme në Kosovë që posedojnë regjistrim ushtarak apo jo-civil.

3. Për qëllimet të paragrafit 1, për renditjen e dytë, shprehja “për përdorim në avionët civil” do të përfshijë mallrat për përdorim në trajnerët fluturues të tokës për përdorim civil.

4. Lirimet nga taksat doganore do ti nenshtrohen kushteve te pershkruara në Nenin 3 të Udhzimin Administrativ(Nr 8/2004) të pershkruara ne dispozitat per procedurat doganore

Megjithatë, këto kushte nuk do të zbatohen në rastet kur avionët civilë që përfshihen në nënkrerët 8802 11, 8802 12, 8802 20, 8802 30, 8802 40 janë regjistruar në regjistrin e një Shteti Anëtar ose të një vendi të tretë në pajtim me Konventën ndërkombëtar Aviacionit Civil të datës 7 dhjetor 1944 dhe referenca është bërë në deklaratën doganore për lëshim në qarkullim të lirë në certifikatën përkatëse të regjistrimit. Dispozitat e Dispozitat paraprake të Nenit, Seksioni I - Rregullat e Përgjithshme, pika C. 4. do të zbatohen mutatis mutandis.

5.Mallrat të cilat lirohen nga taksat doganore janë të përfshira nga krerët apo nënkrerët e poshtë shenuar:

3917 40, 4011 30, 4012 13, 4012 20, 7324 10, 7326 20, 8302 10, 8302 20, 8302 42, 8302 49, 8302 60, 8407 10, 8408 90, 8409 10, 8411, 8412 10, 8412 21, 8412 29, 8412 31, 8412 39, 8412 80 80, 8412 90, 8413 19, 8413 20, 8413 30, 8413 50, 8413 60, 8413 70, 8413 81, 8413 91, 8414 10, 8414 20, 8414 30, 8414 51, 8414 59, 8414 80, 8414 90, 8415 81, 8415 82, 8415 83, 8418 10, 8418 30, 8418 40, 8418 61, 8418 69, 8419 50, 8419 81, 8421 19, 8421 21, 8421 23, 8421 29, 8421 31, 8421 32, 8421 39, 8424 10, 8479 90, 8483 10, 8483 30, 8483 40, 8483 50, 8483 60, 8483 90, 8484 10, 8484 90, 8501 32, 8501 52, 8501 61, 8501 62, 8501 63, 8502, 8504 10, 8504 31, 8504 32, 8504 33, 8504 40, 8504 50, 8507, 8511 10, 8511 20, 8511 30, 8511 40, 8511 50, 8511 80, 8518 10, 8518 22, 8518 29, 8518 30, 8518 40, 8518 50, 8519 81, 8521 10, 8526, 8528 52, 8529 10, 8531 10 95, 8531 20, 8531 80, 8539 10, 8544 30, 8801, 8802 11, 8802 12, 8802 20, 8802 30, 8802 40, 8806 10, 8806 21, 8806 22, 8806 23, 8806 24, 8806 29, 8806 91, 8806 92, 8806 93, 8806 94, 8806 99, 8807 10, 8807 20, 8807 30, 8807 90, 9001 90, 9002 90, 9014 10, 9025, 9029 20 38, 9030 31, 9030 33, 9030 89, 9032, 9104.

Për nënkrerët e mëposhtëshenuara, lirimet nga taksat doganore për produktet për përdorim në aviacion civil aplikohet vetëm për mallrat me përshkrim si në kolonën 2:

Nënkrerët	**Përshkrimi**
3917 21 90, 3917 22 90, 3917 23 90, 3917 29 00, 3917 31, 3917 33, 3917 39 00, 7413 00, 8307 10, 8307 90	Me përshtatje të bashkangjitura
4008 29	Forma profile, të prera në masa
4009 12, 4009 22, 4009 32, 4009 42	Për transportimin e gazeve apo lëngjeve
3926 90, 4016 10, 4016 93, 4016 99	Për përdorime teknike
4504 90, 4823 90	Shtesa, guanicione apo mbyllësa të tjerë
6812 80	Ndryshe nga rrobat, plotësues veshjesh, mbathje dhe veshjet e kokës, letra, kartonat e trashë për lidhje librash, shajku apo ndërthurjet e fibrave të kompresuara të asbestit, në fleta apo role
6813 20, 681381, 6813 89	Me një bazë prej azbesti apo prej substancave të tjera minerale
7007 21	Dritare të përparme, pa kornizë
7322 90	Ngrohësit e ajrit dhe distributorët e ajrit të nxehtë (duke mos përfshirë pjesët e tyre)
7324 90	Pajisje sanitare (duke mos përfshirë pjesët)
7608 10, 7608 20	Me përshtatës të bashkangjitur, të përshtatshëm për të drejtuar gazet apo lëngjet

8108 90	Tuba dhe tubacione, me përshtatje të bashkangjitura, të përshtatshme për drejtimin e gazeve apo lëngjeve prej titaniumit
8415 90	Të makinave të kondicionimit të ajrit të nënkreut 8415 81, 8415 82 apo 8415 83
8419 90	Pjesët e njësive të shkëmbimit të nxehtësisë
8479 89	Bateritë hidropneumatike; Aktuatorët mekanike për ndryshimin e etjes; Njësitë e tualetit të përcaktuara në mënyre specifike; Njomësit e ajrit dhe tharësit e ajrit; Servo-mekanizmat, jo-elektrike; Motorët startues jo-elektrike; startuesit pneumatike për turboreaktor, turbohelikët dhe turbina tjera me gaz; fshirëse xhamash, jo elektrike; rregullatorët helikë jo elektrik.
8501 20, 8501 40	Të një dalje më tepër se 735 W por jo më tepër se 150 kw
8501 31	Motorët me një dalje më tepër se 735 W, gjeneratorët DC
8501 33	Motorët me një dalje jo më tepër se 150 kw dhe gjeneratorët
8501 34	Gjeneratorët me kapacitet më të madh se 375W
8501 51	Me një dalje më tepër se 735 W
8501 53	Të një dalje jo më tepër se 150 kw
8516 8020	Të montuar vetëm me një lidhje elektrike, të mëparshme thjesht të izoluar, të përdorur për kundër ngrirje apo shkrirje
8522 90	Montimet dhe nën-montimet e përbëra prej dy apo më shumë pjesësh apo copëzash të mbërthyer apo të bashkangjitura, për apraturat që futen në nënkreun 819 81 dhe 9519 8990
8529 90	Montimet dhe nën-montimet e përbëra nga dy apo më shumë pjesë apo copëza të mbërthyer apo të montuar së bashku, për aparatura që futen në kreun 8526
8536 70	Konektorët të plastikës për fibra optike pako
8543 7090	Regjistruesit e fluturimeve, sinkronizuesit dhe shëndruesit elektrik, shkrirësit dhe tharsit me rezistenc elektrik
8803 9090	Përfshirë aeroplanët pa motor
9020 00	Përjashtuar pjesët
9029 10	Numëruesit e rrotullimeve elektrike apo elektronike
9029 90	Prej numëruesve të rrotullimeve, treguesve të shpejtësisë dhe takiometrave
9109 10, 9109 90	Me gjerësi apo diametër jo më shumë se 50 mm
9405 10, 9405 60	Prej plastike apo metali bazë
9405 92, 9405 99	Të artikujve të nënkreut 9405 10 apo 9405 60 me bazë metali apo plastike

6. Mallrat siç janë të përshkruara në paragrafin 5 janë të integruara në TARIK në nënkrer të referuara me shënime shtese sipas termeve pasuese

“Hyrjet nën këtë nënkapitull jan çështje që i nënshtrohen kushteve të cekura në pjesën C të Aneksit 1 të ligjit 04-L/163 dhe amandamentet pasuese”.

B. Produktet farmaceutike

1. Lirimi nga taksat doganore dhe T.V.SH është siguruar për produktet farmaceutike të kategorive të mëposhtme:

   (a) substancat farmaceutike të cilët janë të përfshira nga CAS RS (shërbimi I rregjistrimit të abstrakteve kimike) dhe emerat internacionale jo-prononsore (INNs) të rregjistruar në Aneksin 01;

   (b) Kripërat, esteret dhe hidratet e INNs, të cilët janë përshkruar nëpërmjet kombinimit të INN të Aneksit 01 me prefikset apo sufikset e Aneksit 02, me kusht që të tilla produkte janë të klasifikueshme në të njejtin kod gjashtë shifror të Sistemit të Harmonizuar si edhe emrat korrespondues INN

   (c) Kripërat, esteret dhe hidratet e INNs, të cilët janë të dhëna në Aneksin 03 dhe të cilët nuk janë të klasifikueshme në të njejtet krerë gjashtë shifrorë të Sistemit të Harmonizuar si edhe emrat korrrespondues INN;

   (d) Intermediarët Farmaceutik, që janë lëndë përbërëse të përdorura në prodhimin e produkteve farmaceutike të përfunduara të cilat mbulohen nga CAS RN dhe emrat kimike, të renditur në Aneksin 04.

2. Rastet e veçanta:

(a) INNs përfshin vetëm ato substanca të përshkruara në listën e INN-ve të rekomanduara dhe të propozuara të publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetsisë (WHO). Kur numri i substancave të të përfshira nga INN është më pak se ajo e përfshirë nga CAS RN, vetëm këto substanca të përfshira nga INN do të jenë objekt i trajtimit pa taksa doganore dhe T.V.SH;

(b) Kur një produkt i Aneksit 01 apo Aneksit 04 identifikohet nga një CAS RN që i korespondon një izomeri specifik, vetëm ai izomer mund të caktohet për trajtimin pa taksa doganore dhe T.V.SH;

(c) Derivatet e dyfishta (kripërat, esteret dhe hidratet) e INN-ve identifikohet nga një kombinim i një INN-je të Aneksit 01 me një prefiks apo sufiks të Aneksit 02 kualifikohen për trajtimet pa taksa doganore dhe T.V.SH, me kusht që ato janë të klasifikueshme në të njejtin kre gjashtëshifror të Sistemit të Harmonizuar

Shembull: alanine metil ester, hidroklorid

(d) Kur nje INN e Aneksit 01 është një kripë (apo ester), asnje kripë tjetër (apo ester) e acidit korrespondues në INN nuk mund të kualifikohet për trajtimin pa taksa doganore dhe TVSH:

Shembull:oxprenoate potassium (INN): pa taksë doganore
oxprenoate potassium: me taksë doganore

(e) një Leje importi nga Agjensioni i Kosovës për Produkte Medicinale (AKPM), me përshkrimin e saktë të produktit farmaceutik, siq është specifikuar në Anekset 01 deri 04.

C. Kontejnerët dhe materialet paketuese

Dispozitat e mëposhtme zbatohen për kontenierët dhe materialet paketuese të referuara në rregullin e përgjithshëm shpjegues 5(a) dhe (b) dhe të vendosura për qarkullim të lirë në të njejtën kohe si edhe mallrat të cilët ato përmbajnë apo me të cilët ato janë të paraqitur.

1. Kur kontenierët dhe materialet paketuese klasifikohen me mallrat në përputhje me rrregullat e përgjithshme shpjeguese 5, ato do të:

   (a) ngarkohen me të njejtën normë të taksës doganore si edhe mallrat:

   — kur këto mallra i nënshtrohen taksave doganore " ad valorem", apo
   — kur ato janë të përfshira në peshën e taksueshme të mallrave;

   (b) lejohen të liruara nga taksa doganore:

   — kur mallrat janë të liruara nga taksat doganore, apo
   — kur mallrat janë të taksueshme ndryshe nga referenca mbi peshën apo vlerën, apo
   — kur pesha e kontenierеve dhe materialeve paketuese nuk përfshihet në peshën e taksueshme të malllrave.

2. Kur kontenierët dhe materialet paketuese të përfshirë nga rregullat e paragrafit 1 (a) dhe (b) përmbajnë apo janë të paraqitura me mallrat të përshkrimeve të ndryshme tarifore, pesha dhe vlera e kontenierеve dhe materialeve paketuese, për qëllime të përcaktimit të peshës apo vlerës së tyre të taksueshme, duhet të ndahet propocionalisht midis mallrave që përmbajnë, në raport me peshën apo vlerën e këtyre mallrave.

D. Trajtime favorizuese tarifore për shkak të natyrës së mallit

1. Nën kushte të caktuara, trajtimet favorizuese tarifore për arsye të natyres se mallit parashihen për:

   — **Kafshët e gjalla të racës së pastër për riprodhim**

   — **farërat, grupe Qepësh,mallërat për mbjellje**

2. **Kafshët e gjalla të racës së pastër për riprodhim**

   Për qëllim të klasifikimit të kafshëve të gjalla në kreun përkatës për kafshët e racës së pastër për riprodhim dhe për qëllim të mbledhjes së taksës së importit dhe TVSH, një kafshë e gjallë do të konsiderohet si racë e pastër për riprodhim dhe hynë në TARIK- kodet 0101 2100 00, 0102 2110 00, 0102 2130 00, 0102 2190 00, 0103 1000 00, 0104 1010 00 varësisht si u përshtatet me kusht që në pjesën e dytë të cerifikatës së obligueshme të veterinarisë është cekur se kafsha e gjallë eshte për riprodhim (shiko Aneksin 05)

   Norma zero jepet edhe atëherë kur përmbushen kushtet e cekura në Nenin 196 /197 të UA 11/20009 mbi implementimin e kodit doganor dhe të akcizave Ligji Nr.08/L-247 të datës 10 Maj 2024

3. **Farërat,grupe Qepësh, mallërat për mbjellje**

   Për qëllime të klasifikimit të mallërave në kapitujt përkatës për farëra,për grupe të qepve apo për mallrat për mbjellje dhe për qëllime të mbledhjes së taksës doganore dhe TVSH,mallrat duhet të konsiderohen si farëra,grup qepësh apo mallra për mbjellje dhe hynë në TARIK-kodet 0701 1000 00, 0703 1011 00, 1001 9110 00, 1001 9120 00, 1002 1000 00, 1003 1000 00, 1004 1000 00, 1005 1018 00 deri 1005 1090 00, 1201 1000 00, 1206 0010 00 , dhe kreu 1209, vetëm nëse në certifikatën fitosanitare të kërkuar(shiko Aneksin 06) është cekur se mallrat realisht janë për qëllime të mbjelljes apo janë fare apo janë grupe të qepëve.

SHENJAT, SHKURTESAT DHE SIMBOLET

b/f	Shishe të vogla
cm/s	Centimetra(s)për sekond
€	Euro
INN	Emer internacional jo-tregtar(jo-prononsorë)
INNM	Emer internacional i modifikuar jo-tregtar(jo-prononsorë)
ISO	Organizata nderkombetare per standartizim
Kbit	1 024 bits
kg/br	Kilogram, bruto
kg/net	Kilogram, neto
kg/net eda	Kilogram në peshë neto të tharë
kg/net mas	Kilogram neto, lëndë e thatë
MAX	Maximum
Mbit	1 048 576 bits
MIN	Minimum
ml/g	Millilitra(s) për gram
mm/s	Milimetra(s) për sekond
PRO	Ndalim
RON	Numri i kërkuar i oktanit
VET	”Certifikata Veterinare“ është e nevojshme (shiko aneksin 5) vendimi i AVUK-ut Nr.5079/10.12.2012
FIT	”Certifikata Fitosanitare“ është e nevojshme (shiko aneksin 6) vendimi i AVUK-ut Nr.5079/10.12.2012
L04	Ligji Nr. 04/L-190 për produktet dhe pajisjet medicinale “Licenca nga Agjencioni I Kosovës për produkte medicinale (AKPM)” është e nevojshme (shiko aneksin 8)
L05	Ligji Nr. 03/L-220,për Taksat e Akcizës në Prodhimet e Duhanit në Kosovë. Importohet vetëm nga Importuesit e autorizuar nga Ministria e Tregtisë bazuar në UA MTI Nr. 11/2020
L06	Këkohet licenca për Importin e naftës dhe derivateve të naftës në Kosovë sipas Udhëzimit Administrativ Nr, 07/2010
L07	Ligjit Nr. 02/L-128, Licenca e importit dhe eksportit të narkotikëve dhe licenca e importit dhe eksportit të prekursorëve e lëshuar nga Agjencioni i Kosovës për Produktet Medicionale, është e nevojshme për përshkrimet dhe synonimet e përshkrimeve nga tabelat II, III, IV
L08	Çertifikatën për përshtatshmërinë e tipit te mjetit, udhëzim administrativ nr.2008/08 për homoligimin e automjeteve
L09	Leje nga MMPH për import të qeseve të plastikës në form të thasëve pa aditiv për nevoja të industris, sipas vendimit Nr.20 datë 09.07.2013

Shënim:
Numri i kreut i vendosur në mes të kllapave në shtyllën e parë të përmbledhjes së normave doganore tregon se kreu është hequr (psh,kreu[1519])

SEKSIONI I

KAFSHËT E GJALLA; PRODUKTET ME ORIGJINË PREJ KAFSHËVE

Shënime

1. Çdo referencë në këtë Seksion për një specie apo lloj të veçantë të një kafshe, veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, ka të bëjë edhe me atë lloj apo specie kafshe në moshë të re .

2. Veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, gjatë gjithë Nomenklaturës çdo referencë për produktet e "thara" përfshin gjithashtu produktet që janë të dehidratuar, të avulluara apo të thara në ngricë.

PJESA E DYTË

PËRMBLEDHJE

KAPITULLI 1

KAFSHËT E GJALLA

Shënim

1. Ky Kapitull përfshin të gjitha kafshët e gjalla, përveç:

   (a) Peshkut dhe kafshëve guackore që jetojnë nën ujë, molusqeve dhe kafshëve të tjera jovertebrore ujore, të kreut 0301, 0306 ,0307 apo ,0308;
   (b) Kulturave të mikro-organizmave dhe produkteve të tjera të kreut 3002; dhe
   (c) Kafshëve të kreut 9508.

Shënime shtesë (TARIK)

1. Për qëllim të klasifikimit të kafshëve të gjalla në kreun përkatës për kafshët e racës së pastër për riprodhim dhe për qëllim të mbledhjes së taksës së importit dhe TVSH, një kafshë e gjallë do të konsiderohet si racë e pastër për riprodhim dhe hynë në TARIK- kodet 0101 1010 00, 0101 1090 00, 0102 1010 00, 0102 1030 00, 0102 1090 00, 0103 1000 00, 0104 1010 00 apo 0104 2010 00 varësisht si u përshtatet me kusht që në pjesën e dytë të certifikatës së obligueshme të veterinarisë është cekur se kafsha e gjallë është për riprodhim (shiko Aneksin 05)

Kodi i mallrave	Përshkrimi	Njësitë plotësuese	Masa të politikës tregtare		Norma të detyrimit (%)	Norma preferenciale të detyrimit (%)	TVSH (%)	Norma e akcizës
			Importi	Eksporti		CEFTA / MSA / TR / US		
0101	**Kuaj, gomarë, mushka dhe hibrid të gomaricës me kalin, të gjalla:**							
	-Kuajt:							
0101 2100 00	**- - Të racës së pastër për riprodhim**	PCE	VET	-	0	CEFTA : 0 / MSA/GB : 0 / TR : 0/ US:0	8	-
0101 29	**- -Të tjera:**							
0101 2910 00	- - - Për therje	PCE	VET	-	0	CEFTA : 0 / MSA/GB : 0 / TR : 0/ US:0	8	-
